



# **TIC COUNCIL COMPLIANCE PROGRAMME**

*INTEGRITETI, KONFLIKTI I INTERESIT, KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË  
DHËNAVE, ANTI-RRYSHFETI/KORRUPSIONI, SJELLJA E DUHUR NË BIZNES,  
SHHËNDETI DHE SIGURIA, DREJTËSIA NË PUNË*

## **1. Integriteti**

Anëtari do të veprojë në një mënyrë profesionale, të pavarur dhe të paanshme në të gjitha aktivitetet e tij.

Anëtari do ta kryejë punën e tij me ndershmëri dhe nuk do të tolerojë asnjë devijim nga metodat dhe procedurat e miratuara. Kur metodat e aprovuara të provës parashikojnë tolerancë në rezultate, Anëtari duhet të sigurojë që tolerancat e tilla të mos abuzohen për të ndryshuar gjetjet aktuale të testit.

Anëtari do të raportojë të dhënat, rezultatet e provave dhe fakte të tjera materiale në mirëbesim dhe nuk do t'i ndryshojë ato në mënyrë të pahijshme dhe do të lëshojë vetëm raporte dhe certifikata që paraqesin saktë gjetjet aktuale, opinionet profesionale ose rezultatet e marra.

## **2. Konflikti i interesit**

Anëtari do të shmangë konfliktin e interesit me çdo subjekt të lidhur në të cilin ka një interes financiar ose tregtar dhe për të cilin kërkohet të ofrojë shërbime.

Anëtari do të shmangë konfliktet e interesit midis kompanive të Anëtarëve dhe / ose divizioneve të përfshira në aktivitete të ndryshme, por që mund të ofrojnë shërbime ose për të njëjtin klient ose për njëri-tjetrin.

Anëtari duhet të sigurojë që punonjësit e tij të shmangin konfliktin e interesit me aktivitetet e tij si Anëtar.

## **3. Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të Dhënave**

Anëtari do të respektojë konfidencialitetin dhe privatësinë e informacionit të klientit dhe do të sigurojë që ekzistojnë procese për të mbrojtur në mënyrën e duhur informacionin e tillë.

## **4. Anti-ryshfet/korrupsioni**

Anëtari do të shmangë pranimin e ryshfetit në çdo formë, duke përfshirë edhe kthimet në çdo pjesë të një pagese të kontratës.

Anëtari do të ndalojë kategorikisht përdorimin e çdo rruge ose kanali për sigurimin e përfitimeve të papërshtatshme ose marrjen e përfitimeve të tilla nga, klientët, agjentët, kontraktorët, furnitorët, punonjësit e çdo pale, ose zyrtarë qeveritarë.

## **5. Sjellja e Duhur në Biznes**

Anëtari duhet të prezantohet dhe të realizojë marketing, duke përfshirë çdo krahasim ose referencë me konkurrentët ose shërbimet e tyre, në një mënyrë që është e vërtetë dhe jo mashtruese ose që ka gjasa që mund të mashtrtojë.

## **6. Shëndeti dhe Siguria**

Anëtari do të zbatojë trajnimet dhe procedurat e duhura për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, klientëve dhe palëve të treta dhe do të monitorojë incidentet me qëllim minimizimin e rreziqeve gjatë operacioneve të biznesit.

## **7. Drejtësia në punë**

Anëtari është i vetëdijshëm për përgjegjësinë e tij shoqërore për punonjësit e tij, njerëzit, komunitetet dhe mjediset në të cilat punon dhe do të respektojë të drejtat e njeriut.